

TERMA REFERENCE SHËRBIMI I SHOFERIT

"Shëndet për të Gjithë" është një Projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim i zbatuar nga Instituti Zviceran i Shëndetit Publik dhe Mjekësisë Tropikale në Bazel, në bashkëpunim me Qendrën HAP në Shqipëri. Qëllimi i projektit është që popullsia shqiptare të përfitojë shëndet më të mirë falë shërbimeve të përmirësuara të Kujdesit Shëndetësor Parësor.

Qëllimi i shërbimit

Kompania e kontraktuar për të ofruar shërbimet e shoferit do të mbështesë ekipin e projektit HAP në zbatim të përgjigjegjësisë dhe kompetencave të kërkuara më poshtë:

Detyrat dhe Përgjegjësitë

Kompania e kontraktuar do të ofrojë një shërbim të besueshëm dhe të sigurt në drejtimin e automjeteve të projektit HAP, duke garantuar përgjegjshmëri të lartë gjatë ofrimit të këtij shërbimi. Detyrat më në detaj të drejtuesve të automjeteve do të jenë si më poshtë:

- Garantojnë drejtimin e besueshëm dhe të sigurt të automjeteve të caktuara nga projekti për transportin e personelit të autorizuar të Qendrës HAP dhe ekspertëve (kur kërkohet); zbatojnë në mënyrë të përpiktë të gjithë rregullat në lidhje me përdorimin dhe menaxhimin e automjeteve të HAP, siç parashikohet nga Manuali Operacional i Qendrës HAP;
- Këshillojnë dhe mbajnë plotësisht përgjegjësinë për zgjedhjen e itinerarit më optimal të rrugës për në/nga destinacioni i udhëtimit; të jenë të përgatitur të udhëtojnë në zonat e veprimit të projektit, në periudha të gjata, si dhe të punojnë jashtë orarit normal të punës, nëse do të jetë e nevojshme;
- Të garantojnë parkimin e automjetit në vend-parkime të sigurta dhe të autorizuara;
- Sigurojnë mirëmbajtjen e automjeteve të caktuara duke përfshirë kontrollin e motorit, baterinë, nivelin e vajit, ujit dhe elektroliteve, frenat, kandelet, konsumin e karburantit, presionin e gomave etj. Marrin masa për të dërguar makinën për riparime të mëdha (nëse ka nevojë), ndjekin në kohë ndërrimin e nevojshëm të vajit dhe filtrave, sigurohen që makina të jetë e larë etj.
- Bëjnë të mundur shkurtim të shpenzimeve nëpërmjet përdorimit të duhur të automjetit dhe mbajtjes së saktë të regjistrave të automjetit në varësi të ditëve të shërbimit;
- Sigurojnë disponueshmërinë e gjithë dokumentacionit të nevojshëm të automjetit si siguracioni, kolaudimi, pagesat e taksave, regjistrat e automjetit, kilometrazhin ditor, konsumin e karburantit, kutinë e ndihmës së shpejtë, pjesë të nevojshme këmbimi në automjetin e caktuar. Garantojnë ndjekjen e të gjitha hapave dhe masave të nevojshme në rast aksidenti sipas legjislacionit në fuqi;
- Kryejnë çdo detyrë që u caktohet nga mbikqyrësi.

Kompetenca

- Njohuri të rregullave dhe rregulloreve të trafikut dhe aftësi në riparime të vogla të automjetit;
- Aftësi për qasje pozitive ndaj punës, me energji dhe qëndrim konstruktiv;
- Aftësi për të ruajtur qetësinë, kontrollin dhe garantuar një gjendje të mirë emocionale edhe në situata stresuese;
- Aftësi të shkëlqyera ndërpersonale/komunikuese.

Aftësi dhe kompetenca të preferuara

- Punë të mëparshme në organizata ndërkombëtare;
- Njohuri të gjuhës angleze.



Aftësi dhe eksperiencia të kërkuara

Shkollimi:

- Të ketë përfunduar arsimin e mesëm;

Eksperiencia:

- Të paktën 5 (pesë) vite eksperiencë në drejtim automjeti si shofer profesionist;

Çertifikata profesionale

- Leje të vlefshme të drejtimit të automjetit (kategoria B)